



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË RREGULLORES
KOMUNALE NR. 01/2022 PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE
PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE E
NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2024**

Mitrovicë e Jugut

Shkurt 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Në bazë të dispozitave të nenit, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a) të Ligjit Nr. 03L-040 Për vetëqeverisjen lokale, neni 4, 5, 6 dhe 7 Rregullores (MAPL) nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, neni 13, paragrafi 1, nën-paragrafi 3, neni 46, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 dhe neni 84, paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Komisioni i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës me nr. prot. 01-020/04-0005970/26 të datës 02.02.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë 10.02.2026, përgatiti këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIM DHE NDRYSHIM TË RREGULLORES KOMUNALE NR. 01/2022 PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE E NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 02/2024

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës Komunale e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2024.

Neni 2

1. Neni 19, paragraf 1, nënparagrafi 1.13 i Rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet në vijim:
1.13. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër;
2. Neni 19, paragrafi 1 plotësohet si në vijim:
1.15 Drejtoria e Pronës

Neni 3

1. Neni 80 i Rregullorës bazë, titulli ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.
2. Neni 80, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

3. Neni 80 i rregullorës bazë i fshihen nën-paragrafët 1.5, 1.6, 1.7, 1.18, 1.19 dhe 1.20.

Neni 4

1. Neni 81 i rregullorës bazë ndryshohet dhe riformulohet titulli në Organizimi i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit.
2. Neni 81, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet në: Funkcioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastrë do të bazohet në këta sektor:
3. Fshihet nën-paragrafi 1.3 i neni 81 i rregullorës bazë.

Neni 5

1. Neni 84 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim: Drejtoria e Pronës.

Neni 6

2. Pas neni 84 shtohen edhe 3 nene të reja dhe atë:

Neni 84

Drejtoria e Pronës

1. Menaxhon me pronën në pronësi të komunës;
2. Zhvillon procedurën e vlerësimit të pronës sipas kriterëve, standardeve dhe akteve normative në fuqi;
3. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës së pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
4. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera konform dispozitave ligjore në fuqi;
5. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e konstestëve për tokën;
6. Përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimi i tokës shtetërore dhe efikasiteti në taksimin e tokave;
7. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryen procedurat e blerjes, dhënies në këmbim dhe shfrytëzim të pronës komunale.
8. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridik për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;

9. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje;
10. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;

Neni 84A

Organizimi i Drejtorisë së Pronës

1. Drejtoria e Pronës organizohet në këto sektor:
- 1.1. Sektori i Pronës;
- 1.2. Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale.

Neni 84B

Sektori i Pronës

1. Menaxhon me pronën e patundshme në pronësi të komunës;
2. Bënë vlerësimin e pronës së patundshme sipas kriterëve, standardeve dhe akteve ligjore në fuqi;
3. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera administrative;
4. Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve pronësore dhe mbajtja e evidencës për pronat komunale që gjenden në procedurë gjyqësore;
5. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizik dhe juridik për rregullimin e mardhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;
6. Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur me këtë çështje.

Neni 84C

Sektori për Shpronësime, Këmbime dhe Shfrytëzim të Pronës Komunale

1. Kujdeset dhe mban evidencat e të dhënave pronësore ku bartës i të drejtës pronësore dhe e shfrytëzimit është Kuvendi Komunal;
2. *Menaxhon me procedurat për ndarjen e ngastrave;*
3. Menaxhon me procedurat dhe çështjet që kanë të bëjnë me shpronësime të pronës së paluajtshme;
4. Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës së patundshme komunale, realizim e pagesave nga kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale dhe kryen procedurat e blerjes, këmbimit dhe të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;
5. Bënë vërtetimin dhe zbaton procedurat për shitblerjen e pronës së patundshme;

6. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për pronat që përfshihen në interes publik;
7. Nxjerr aktvendime, konkluzione dhe akte tjera administrative;

Neni 7

Pjesë përbërse e kësaj rregullorje është organogrami i përgjithshëm i Komuns së Mitrovicës së Jugut të cilin duhet të jetë në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje është Lista e Klasfikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet Kamberi